



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.0.1-2013-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013

Prishtinë, qershor 2014

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Kuvendit të Kosovës në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit Vlora Mehmeti, i mbështetur nga Agron Fetiu (Udhëheqës Ekipi), Ariana Berisha-Rexhëbeqaj dhe Fanol Hodolli.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak	9
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	10
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	18
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	21

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2013 - i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2013 u ndërmorr në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorin Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit të datës 19/11/2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pasqyrat Vjetore Financiare - pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe çështjet e tjera të theksuara në Memon e Planifikimit të Auditimit;
- Adresimin e rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit.

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale* **(ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar)**.

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Sistemi i kontrolleve të brendshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës është dizajnuar në mënyrë të duhur dhe ka funksionuar mirë me përjashtim të disa rasteve të cilat nuk e ulin kredibilitetin e sistemeve të kontrollit.

Kontrollet menaxheriale ishin efektive gjatë tërë vitit 2013 pothuajse në të gjitha fushat e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Këto kontrolle kanë siguruar që Pasqyrat Vjetore Financiare të përgatiten në pajtueshmëri me kërkesat ligjore në fuqi. Po ashtu, Kuvendi ka përmbushur edhe kërkesat e tjera aktuale për raportim të jashtëm.

Realizimi i buxhetit në nivel prej 97% është një tregues që Kuvendi në vazhdimësi bënë përpjekje që planifikimet buxhetore të bëhen në përputhje me nevojat reale të organizatës.

Po ashtu, kontrollet ishin adekuate edhe në fushën e tjera të menaxhimit financiar dhe kontrollit sin ë menaxhimit ë pagave dhe medetjeve, menaxhimit të pasurisë, subvencioneve dhe obligimeve të papaguara.

Megjithatë, për avancimin e mëtutjeshëm të kontrolleve, Kuvendi duhet të shtoj nivelin e kontrolleve në fushën e buxhetit për investime kapitale dhe në zhvillimin e procedurave të prokurimit. Më tutje, nevojitet zbatimi i një procesi me efektivitet të Komitetit të auditimit për të siguruar efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Ne po ashtu, kemi marrë në konsideratë përgjigjet e Kuvendit ndaj rekomandimeve tona të bëra në vitin 2012 - pozita aktuale është përmbledhur në Shtojcën II. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është që Kuvendi kishte qasje pozitive për t'i adresuar rekomandimet e vitit paraprak por nuk ka arritur në tërësi t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

Rekomandimet tona kryesore për Kryetarin e Kuvendit të Kosovës janë si në vijim:

Përmes Sekretarit të Përgjithshëm të siguroj:

- Shtimin e mbikëqyrjes së vazhdueshme të realizimit të buxhetit për investime kapitale për të siguruar arritjen e objektivave të parapara me planifikimet buxhetore; dhe
- Aplikimin e kontrolleve në proceset dhe procedurat e prokurimit në mënyrë konsistente gjatë gjithë vitit për të siguruar pajtueshmëri të plotë me kriteret dhe rregullat e përcaktuara.

Përgjigja e Menaxhmentit - auditimi 2013

Menaxhmenti është pajtuar me të gjeturat tona të auditimit dhe është zotuar se do ti adresojë rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Kuvendit të Republikës së Kosovës (KRR) të përgatis Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për "Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar shkallën deri në të cilën mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale gjatë përcaktimit të testimit të hollësishëm, të cilat janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) dhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2012 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Konkluzioni i përgjithshëm

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklaratë kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se PVF janë të cilësisë së mirë dhe shpalosjet e dhëna ofronin sqarime të mjaftueshme për aktivitetet financiare dhe operative të Kuvendit për vitin 2013. Po ashtu, të gjitha obligimet e tjera të raportimit të jashtëm që nuk kanë bërë me PVF-të ishin përmbushur plotësisht.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i pamodifikuar¹

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale **(ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar)**.

¹ Termi „opinion i pamodifikuar“ është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar“ i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (ISSAI 200). Për më shumë informacion referohu në shtojcën I.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

Përshkrimi

Pasqyrat vjetore financiare duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Rregullën e MF-nr 03/2013-Për Pasqyrat financiare vjetore të organizatve buxhetore; dhe
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Marrë parasysh atë më lart - Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, mund të konsiderohet e drejt dhe e vërtet.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.3 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

Përshkrim

Përveç hartimit të PVF-ve, nga KRK kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesat Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Planin e veprimit për adersimin e rekomandimve të auditimit;
- Plani preliminar dhe final të prokurimit me kohë;
- Raportet për borxhet e papaguara;
- Raportet e progresit për projektet kapitale me vlerë mbi 10,000€ janë dorëzuar në Ministrinë e Financave (MF); dhe
- Raportin mbi kontrollin e brendshëm, përfshirë raportin e vetëvlerësimit.

Ne nuk kemi çështje për të ngritur në lidhje me këto. KRK ka përmbushur kërkesat për raportim të jashtëm me cilësinë e duhur dhe duke i respektuar afatet kohore.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Kuvendi ka ndërmarrë masa konkrete për t'i adresuar shqetësimet e ngritura në raportimin e auditimit për vitin 2012. Ka një progres të dukshëm sa i përket adresimit të rekomandimeve, por çështja lidhur me zbatimin e një procesi më efektiv të Komitetit të Auditimit duhet të adresohet më tutje.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2012 të KRK-së ka rezultuar me tri rekomandime kryesore. KRK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku janë paraqitur veprimet që do të ndërmerren për adresimin e të gjitha rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2013, dy rekomandime janë adresuar plotësisht; ndërsa një është adresuar pjesërisht. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Rekomandim

Çështja 1 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i mesëm

- | | |
|----------------------|---|
| E gjetura | Rekomandimi i vitit të kaluar lidhur me shtimin e rolit të Komitetit të Auditimit nuk është adresuar. Komiteti i auditimit në takimet e mbajtura nuk ka trajtuar rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm dhe të ZAP-së. |
| Rreziku | Mos trajtimi i rekomandimeve të dhëna në takimet e Komitetit të Auditimit zvogëlon mundësin për t'a mbështetur menaxhmentin në adresimin e përgjegjësive për zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. |
| Rekomandimi 1 | Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që Komiteti i Auditimit në mënyrë proaktive shqyrton planet, rezultatet dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të ZAP-së. |

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Kjo mund, për shembull, të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrolleve operative të nivelit më të ulët.

Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Megjithëse, në disa aspekte, siç është ai i menaxhimit të buxhetit, proceset e prokurimit ende kanë nevojë për përmirësim. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti.

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se Kuvendi ka dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm i cili ka gjeturë zbatim pothuajse në të gjitha fushat e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Procesi buxhetor ishte në përputhje me parashikimet buxhetore për vitin 2013 megjithatë për avancim të mëtutjeshëm nevojitet përmirësimi në fushën e menaxhimit të buxhetit për investime kapitale. Me qëllim të sigurimit të pajtueshmërisë së plotë me kërkesat ligjore, shtimi i kontrolleve në menaxhimin e shpenzimeve përmes prokurimit është po ashtu i nevojshëm. Në këtë aspekt, Komiteti i auditimit duhet t'i ndihmoj menaxhmentit për të siguruar efektivitetin e sistemit të auditimit të brendshëm.

Përderisa, kontrollet ishin adekuate në fushat e tjera të menaxhimit financiar dhe kontrollit përfshirë menaxhimin e shpenzimeve për paga dhe meditje, menaxhimin e pasurisë, menaxhimin e subvencioneve dhe obligimeve të papaguara.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për KRK, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Burimet e Fondeve:	16,810,692	17,888,093	17,307,643	16,492,680	15,932,921
Granti i Qeverisë -Buxheti	16,810,692	17,881,793	17,301,343	16,474,020	15,931,298
Donacionet e jashtme	0	6,300	6,300	18,660	1,623

Buxheti final, krahasuar me buxhetin fillestar, është më i lartë për 1,077,401€. Kjo rritje është si rezultat i donacioneve të jashtme në shumën prej 6,300€, si dhe rritjet para dhe pas rishikimit buxhetor me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2013, KRK ka shpenzuar 97% të buxhetit final, krahasuar me vitin 2012 ka një ngritje të shpenzimeve për 5%. Në total ekzekutimi i buxhetit mbetet në nivelin e kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike/ realizimi ndaj buxhetit(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	16,810,692	17,888,093	17,307,642	16,492,680	15,932,921
Pagat dhe Mëditjet	5,484,367	5,340,217	5,101,873	5,314,910	5,722,682
Mallrat dhe Shërbimet	1,454,325	1,632,304	1,563,205	1,384,208	1,414,769
Shërbimet komunale	221,000	198,500	183,972	176,393	163,639
Subvencionet dhe Transferet	8,621,000	9,821,000	9,820,900	8,924,999	7,904,999
Investimet Kapitale	1,030,000	896,072	637,692	692,170	726,831

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti për Investime Kapitale gjatë vitit është zvogëluar për 15%, ndërsa vetëm 72% e buxhetit për këtë kategori është realizuar. Programi për Investime Publike (PIP) me buxhet fillestar përfshin katër projektet në vazhdim nga viti i kaluar dhe dy projekte të reja për vitin 2013. Nga gjashtë projektet e parapara me buxhetin fillestar dy prej tyre nuk janë realizuar fare, (Vila Gërmia dhe Blerja e veturave për nevojat e KRK). Deri në fund të vitit 2013 në kuadër të projekteve kapitale KRK ka projektuar edhe katër projekte të reja të cilat janë evidentuar edhe në sistemin e PIP-it;
- Ngritja e buxhetit për Subvencione dhe transfere është bërë me vendimet e Qeverisë në shumën prej 1,200,000€ për subvencionimin e RTK-së;
- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar për Paga dhe Mëditje është zvogëluar për 2.7%, si rezultat i mos rekrutimit të punëtorëve të rinjë dhe mos kompenzimeve të anëtarëve të Kuvendit për shkak të mungesave në séanca;
- Ndërsa te kategoria e Mallra dhe Shërbime kemi një ngritje të buxhetit final në raport me buxhetin fillestar si rezultat i obligimeve të bartura nga viti paraprak dhe disa projekteve të paparashikuara; dhe
- KRK ka pranuar grande nga donatorët e jashtëm në vlerën 6,300€, të cilat ishin alokuar për Paga dhe Mëditje dhe Mallra Shërbime. Realizimi i tyre është në nivel të kënaqshëm.

Rekomandim

Çështja 2 - Ekzekutimi i buxhetit për Investime Kapitale jo në nivelin e pritur- Prioriteti i Lartë

- E gjetura** Ekzekutimi i buxhetit në kategorin e Investimeve Kapitaleve nuk ishte në nivelin e pritur (e buxhetuar). Ky nivel i ekzekutimit në Investime Kapitale në raport me planin është si rezultat i vonesave në iniciimin e procedurave të prokurimit për realizimin e tyre³ si dhe ri-tenderimit në mungesë të operatorëve ekonomik të përgjegjshëm.
- Rreziku** Ekzekutimi i buxhetit jo në nivelin e pritur te kapitalet do të rezultojë me shfrytëzim të ulët të buxhetit, si dhe në mos realizimin e projekteve të planifikuara kapitale.
- Rekomandimi 2** Sekretari i Përgjithshëm duhet ta bëjë një vlerësim sistematik të arsyeve në lidhje me nivelin jo të pritur të ekzekutimit të buxhetit për Investime Kapitale, për të identifikuar me kohë arsyet dhe të marr masa për evitimin e mangësive qoftë në fazën e planifikimit apo në fazën e ekzekutimit të buxhetit.

³ Tri projektete lidhur me Modernizimin dhe pajisja me teknologji digjitalet për salla dhe Renovimi i ndërtesës dhe instalimeve elektrike janë planifikuar të fillojnë në muajin Janar 2013 përderisa kërkesa për iniciimin e procedurave ka filluar në muajin Maj dhe Tetor 2013.

4.3 Shpenzimet

4.3.1 Prokurimi

Përshkrimi

Në vitin 2013, KRK ka shpenzuar 1,880,259€ përmes procedurave të prokurimit.

Sistemi i prokurimit në kuadër të KRK-se është funksional. Prokurimet e realizuara janë në përputhshmëri me procedurat e kontrollit të brendshëm nga proceset e përcaktimit të projekteve, buxhetin e aprovuar, si dhe investimet kapitale përmes sistemit të PIP-it.

Në tërësi sistemi i prokurimit ka funksionuar mirë me përjashtim të disa rasteve të cilat do t'i prezantojmë më poshtë.

Rekomandimet

Çështja 3 - Nënshkrimi i kontratës pa mjete të zotuar - Prioritet i lartë

- | | |
|----------------------|---|
| E gjetura | KRK ka lidhur kontratë me Operatorin Ekonomik (EO) për „Rifreskimin dhe pavarësimin e sistemit të TIK-ut (e-Parlamenti) për nevojat e Kuvendit të Kosovës” në vlerë prej 235,000€, pa u bërë paraprakisht zotimi i mjeteve. Kontrata është lidhur me 10 Maj 2013, ndërsa mjetet janë zotuar 17 ditë pas nënshkrimit të kontratës. |
| Rreziku | Hyrja në obligime pa fonde të zotuar rritë rrezikun që të mos mund të financoj në tërësi projektet. Kjo mund të rezultoj me dështim të kryerjes së tyre. |
| Rekomandimi 3 | Sekretari i Përgjithshëm duhet paraprakisht të sigurojë se janë zotuar fondet buxhetore për projekte, në mënyrë që ato të realizohen në linjë me kontratat e arritura dhe me kohë. |

Çështja 4 - Nënkontraktimi i pa autorizuar - Prioritet i lartë

E gjetura Në kontratën e nënshkruar me OE për “Ndërrimin dhe montimin e dyerve automatike në garazh” në vlerë prej 9,750€ ishte paraparë se OE nuk duhet të nënkontrakttoj pa autorizim paraprak me shkrim nga Kuvendi. Ne kemi vërejtur se OE i shpërblyer me kontratë ka bërë nënkontratë me një OE tjetër në vlerë prej 4,734€. Për këtë nuk e ka njoftuar Kuvendin.

Sipas KRK-se OE nënshkrues i kontratës nuk ka nënkontraktuar ndonjë Operator tjetër për kryerjen punëve mirëpo, dokumenti për nënkontraktim është lidhur për projektin në fjalë.

Rreziku Kontrolli i pamjaftueshëm në dokumentacionet e ofruara nga operatorët ekonomik mund të rezultoj me ofrimin e mallrave dhe shërbime jo në përputhje me kërkesat dhe në vonesa në realizimin e punëve.

Rekomandimi 4 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që janë shtuar kontrollet në dokumentet e ofruara nga OE për të siguruar që nënkontraktimet bëhen vetëm pas autorizimit nga KRK.

4.3.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrim

Këto shpenzime përfshijnë të gjitha blerjet që nuk kanë nevojë për procedura të prokurimit, siç janë shërbimet komunale, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, shpenzimet e reprezentacionit dhe shpenzime tjera. Testimet tona nuk kanë rezultuar me ndonjë mangësi.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.3.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet janë paguar përmes sistemit të centralizuar. Kontrollet që operojnë lokalisht nga KRK kanë të bëjnë me autorizimin e Payroll-it, një shqytim i variancave dhe harmonizimeve të brendshme.

KRK përbëhet nga: 120 Anëtarë të Kuvendit, 172 punësuarë në Administratën e Kuvendit dhe 30 staf mbështetës politik.

Po ashtu edhe kompensimi shtesë për paga dhe mëditje për të punësuarit në administratë dhe stafin mbështetës politik kanë qenë në përputhshmëri me vendimet përkatëse.

Testimet tona nuk kanë shpalosur ndonjë mangësi për sa i përket kompensimeve për paga dhe meditje.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.3.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Subvencionet e dhëna nga KRK kanë qenë për përfituesit publik dhe jo publikë.

Subvencionet për entitetet publike janë në shumën 9,808,899€. KRK kishte transferuar 9,760,999€ në llogari të Radio Televizionit të Kosovës sipas ndarjes buxhetore. Mjetet e transferuara kanë qenë sipas rekomandimit të komisionit për buxhet dhe financa në kuadër të Kuvendit.

Po ashtu subvencionet tjera për përfituesit publik dhe jo publik janë dhënë në bazë të vendimeve paraprake të nxjerrura dhe aprovuar nga personat e autorizuar.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.4 Pasuritë dhe obligimet

4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

KRK, disponon me regjistrin e përgjithshëm të pasurisë si dhe ka bërë inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive në fund të vitit sipas kërkesave ligjore.

Vlera e pasurive kapitale (mbi 1,000€) e paraqitur në PVF ishte 7,133,270€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale (nën 1000€) ishte 502,786€. Në PVF, pasuritë janë paraqitur sipas vlerës së tyre neto.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.4.2 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2013 ishte në shumën prej 35,622€. Obligimet e pa kryera, kryesisht kanë të bëjnë me shpenzime komunale, të reprezentacionit, derivateve etj.

Arsya e mospagesës së faturave ishte përfundimi i vitit fiskal, faturat kanë ardhur pas datës së mbylljes së pagesave sipas udhëzimit për mbylljen e vitit. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2013.

Ndërsa obligimet e papaguar të vitit 2012 të cilat janë bartur në vitin 2013 ishin 103,662€ të gjitha këto obligime ishin paguar në afatin e paraparë me ligj.

Gjatë testimit nuk kemi vrejtur ndonjë parregullsi të obligimet e papaguara.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë .

4.5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm. Ne kemi marrë parasyshë fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit. Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë, si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe komiteti i auditimit.

KRK, ka të themeluar NjAB, që përbëhet nga Drejtori i Auditimit të Brendshëm.NJAB ka përgatitur një plan vjetor dhe strategjik të auditimit për 2013-2015.

Për vitin 2013, Auditori i Brendshëm kishte planifikuar pesë auditime të rregullta si dhe dy auditime sipas kërkesave (auditimet ad-hoc). Planifikimi ishte bërë në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe prioriteteve, duke e fokusuar auditimin në disa fusha të ndryshme.

NjAB, gjatë vitit ka hartuar raporte tre mujore, si dhe raportin vjetor për auditimet e kryera dhe aktivitetet e AB-së. Në të gjitha raportet e auditimit ishin raportuar çështjet për përmirësim për fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe për të cilat ishin dhënë rekomandime konkrete.

Gjatë vitit, komiteti kishte mbajtur gjithsej tri takime të rregullta, ku është diskutuar për statutin e Komitetit të auditimit, planin vjetor 2014 dhe planin startegjik 2014-2016 si dhe për memorandumit e përkohshëm të auditimit të dhënë nga ZAP.

Rekomandim

Çështja 5 - Mbështetje jo e mjaftueshme nga Komiteti i auditimit -Prioritet i mesëm

E gjetura Komiteti i Auditimit gjatë vitit 2013 ka mbajtur gjithsej tri takime të rregullta. Përderisa rregullorja nr.11/2010 për themelimin dhe funksionimin e KA kërkon që komiteti për të ndihmuar menaxhmentin në përmirësimin e kontrollit të brendshëm duhet të mbajë së paku katër takime gjatë vitit.

Po ashtu, në asnjë nga takimet e mbajtura, KA nuk i ka trajtuar raportet e auditorit të brendshëm dhe procesin e implementimit të rekomandimeve të dhëna nga Auditori i Brendshëm dhe Auditori i Jashtëm.

Rreziku Mos mbajtja e takimeve të rregullta dhe mos trajtimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm nga KA, zvogëlon sigurin mbi efektivitetin e sistemit të auditimit të brendshëm dhe nuk i ndihmon Menaxhmentit në përmirësimin e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike.

Rekomandimi 5 Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë që KA kryen përgjegjësit e caktuara në përputhje me udhëzimin administrativ duke mbajtur takime të rregullta së paku katër herë në vit dhe në takime të trajtohen rekomandimet e dhëna nga Auditori i Brendshëm dhe Auditori i Jashtëm.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornizë për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk përhapen në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë materiale por nuk përhapen.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe përhapen në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë edhe materiale edhe të përhapen. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 170519 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;

Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
4.3 Kerkesat e raportimi i jashtem	Do të ndërmerren hapat e duhur që të siguroj se janë përgaditur raportet për vetëvlerësimin dhe kontrollet e brendshme për të gjithë sektorët e KRRK-së.	Po		
\$.4 Shpenzimet prokurimi	Mos kryerja e furnizimeve në afatin e përcaktuar me kontratë.	Po		
5. Sistemi auditimit te brendshem 1. Fokusimi i auditimit te brendshem ne aktivitet aktuale; 2. Trajtimi i rekomandimeve te AB-se dhe ZAP-it nga Komiteti i Auditimit.			NjAB është fokusuar në auditimin e aktiviteteve aktuale. Mirëpo rekomandimi lidhur me trajtimin e zbatimit të rekomandimeve të AB-së dhe ZAP-it nga Komiteti i Auditimit mbetet i pa adresuar.	